



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



Për	INFRA PLUS Shpk,Rruga Luan HARADINAJ Sol1 H1 Prishtinë; Musa ISLAMAJ
Nga	Zyra e Prokurimit;
Datë	19/03/2019
Lënda	Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim lidhur me lëndën: Nr i prokurimit:642-19-503-2-1-1 Nr i brendshëm642/19/002/211
Përgjigje	Titulli: Hartimi dhe mbikëqyrja e projekteve për investime kapitale dhe projekteve për objekte në pronësi Komunale.

Të nderuar,uroj te jeni mir

Se pari ju falenderoj për interesimin tuaj dhe ne si Zyre e Prokurimit ju konfirmojm se te gjitha procedurat e prokurimit në lidhje me Njoftimin për kontratë,DT dhe procedurat tjera që kanë të bëjnë me prokurimin në fjalë janë zhvilluar sipas ligjit te Prokurimit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, LPP Nr 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe ju konfirmojë dhe ne ju japim një përgjigje detale në lidhje me kërkesen për rishqyrtim si vijon:

Në lidhje me pretendimin tuaj, se është diskriminuese kërkesa që stafi (inxhinierët) të jenë të deklaruar në ATK së paku nga tremujori i vitit 2018, ju sqarojmë se kjo kërkesë është vendosur që të aplikojnë operatorë ekonomikë me përvojë dhe serioz në fushën e hartimit dhe mbikqyrjes së projekteve, sepse vetëm kompanitë që kanë staf profesional në përbërjen e vet mund ti kryejnë të gjitha këto shërbime me seriozitet dhe profesionalizëm të lartë.

Gjithashtu kjo kërkesë ka të bëjë edhe me arsyen se operatorët ekonomik duhet ti deklarojnë punëtorët e tyre në ATK dhe mos të ketë diskriminime në sektorin privat, për stafin profesional dhe me qëllim që operatorët ekonomik të jenë të përgjegjshëm ndaj obligimeve shtetërorë që ju takojnë.

Normalisht që kompanitë të cilët merren me aktivitete tjera, jashtë kësaj natyre të prokurimit, nuk mund ta plotësojnë kërkesën e lartpërmendur, por këtë kërkesë mund ta plotësojnë operatorët ekonomik të cilët janë të specializuar në këtë fushë me një staf profesional permanent dhe me përvojë.

Prandaj është i paqëndrueshëm pretendimi juaj se kjo kërkesë është diskriminuese dhe është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, dhe është i paqëndrueshëm pretendimi juaj se nuk është respektuar neni 1 i LPP-së, sepse qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen,procedurat që do të ndiqen,të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat,operatorët ekonomik, ndërmarrjet,autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë,përfshihen,marrin pjesë ose interesohen,në aktivitete te prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Duke pasur për bazë faktet e lartpërmendura, kuptohet se qëllimi i këtij Ligji mund të arrihet nëse nënshkruhen kontrata me operator ekonomik të specializuar dhe që kanë staf profesional adekuat dhe staf permanent stabil në përbërjen e vet.

Gjithashtu është i paqëndrueshëm edhe pretendimi i juaj se këto kërkesa bijnë në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së, sepse duke i vendosur ato kërkesa, ne kemi kërkuar që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë aftësit e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla.

Njëkohëisht edhe neni 69.8 i LPP-së, e parasheh qartë se operatorët ekonomik mund të mbështeten edhe në subjekte tjera për realizimin e projekteve. Po ashtu edhe neni 71 parasheh që operatorët ekonomik mund të ofertojnë edhe në grupe, pra si konsorciume për të plotësuar kërkesat e vendosura nga autoritetet kontraktuese duke i plotësuar deklaratat sipas nenit 27.1 (a,b,c dhe d) të RRUOPP.

Prandaj kërkesat e lartpërmendura nuk janë favorizuese sepse janë mundësi të hapura për operatorë ekonomik që të themelojnë konsorciume për pjesëmarrje në tender, nëse eventualisht nuk mund ti plotësojnë këto kërkesa individualisht.

Sa i përket pretendimit tuaj, që ne e kemi shkelur nenin 51 të LPP-së dhe nenin 26.3 të RRUOPP, ne ju sqarojmë se është pa bazuar ky pretendim, sepse ne, në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë i kemi paraparë të gjitha dokumentet që duhet ti plotësojnë operatorët ekonomik dhe normalisht që të gjitha kërkesat janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Lidhur me pretendimin tuaj se ne kemi vendosur çmime për njësi por që kemi bërë shkelje sepse nuk kemi parashikuar sasi të indikative, ne ju sqarojmë në këtë rast ne nuk kemi mundur të parashikojmë sasi të përafërta, prandaj kemi qenë të detyruar që të vendosim sasi të vetëm për 1, mirëpo me këtë përcaktim nuk favorizohet dhe nuk dëmtohet asnjë operator ekonomik sepse për të gjithë operatorët ekonomik vlen standardi i njëjtë, pra çmimi për njësi.

Sa i përket pretendimit tuaj për shkelje të nenit 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, ju sqarojmë se kjo dispozitë ka të bëjë me sqarimin e tenderëve gjatë fazës së vlerësimit të tyre, prandaj në këtë fazë ne nuk kemi të bëjmë me vlerësimin e tenderëve, kështu që ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Ju falenderojm për mirëkuptim.

Respect Drejtoria e Prokurimit.

Data : 19/03/2019.